

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ku puqen e ku jo analogjitë Shqipëri-Serbi?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/ku-puqen-e-ku-jo-analogjite-shqiperi-serbi-i570900
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:35:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 korrik 2026, 09:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8f93b0a712d03097ef24c3e34cb7dbec0d235f8d503b74d3ef46ff7a8443963
TEKSTI	ec87d8b0f3affb4b892133877665b0fe65e7bf5d01ca38a853b6464d137aaa28
PAMJA	bdc475ada5036a1b9d92609caf974c066582b643593d0ddfe67ea08a40924583

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f26f5d9eee1886313725ac0a72efbcaec44ff2362b42a8b704d329fb5baefa90
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ce7404fea9547f7baed0d25532c9a74ec9d95bb0671ef1d2d9a3084bcef35e09
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmSkaPdmqPqwwLNW5etCHb3hJy6s89F3sGnMGHdqRXeFrz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f26f5d9eee1886313725ac0a72efbcaec44ff2362b42a8b704d329fb5baefa90>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 English



le [Katalogu politik i revolucionit permanent](#) Serbia abstenoj per harten e re ne OKB, me arsyetimin se Kosova u shtaq si shtet i pavarur Momente paniku ne Itali, futbollistit r fundit

Ku puqen e ku jo analogjitë Shqipëri-Serbi?



1 Korrik 2026, 11:40 Blog Nga Veton Surroi

Shqipëria ka shansin që të vazhdojë rrugëtimin që po e bën Serbia me lëvizjen studentore dhe ta ripërsërisë formën e pushtetit apo që të përbashkojë energjitë e të gjithëve-Qeveri, SPAK, BE, Lëvizja Flamingo-drejt një caku tjetër

1.

“Vuçiqi ra, tash e ka radhën Rama” u dëgjua në protestat e Tiranës dhe ishte njëri prej indikatorëve se si lehtësia e analogjive mund të mashtrojë.

Presidenti i Serbisë në fakt paralajmëroi dorëheqjen e tij prej postit të presidentit dhe gatishmërinë për t’u kandiduar për kryeministër në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen vitin e ardhshëm. Kështu, presidenti Vuçiq u dorëhoq nga pushteti po aq sa u dorëhoq nga pushteti presidenti Putin për t’u bërë kryeministër më 2012.

“Rënia” e Vuçiqit më 2026 mund ta gjejë shëndosh e mirë në pushtet për aq mandate pushteti sa të ketë nevojë. Dhe me këtë presidenti i Serbisë ka treguar se protesta popullore, e përkrahur gjithandej shtresave të shoqërisë dhe e vetëkonsideruar si një me “kauzë të drejtë” jo domosdoshmërisht do të rrëzojë një pushtet i cili është i perceptuar gjerësisht si i padrejtë.

Pushteti në Serbi e konsideroi lëvizjen e studentëve si sfidën kryesore ekzistenciale ndaj tij dhe ishte i gatshëm të përgjigjet në dy mënyrat thelbësore me të cilat protesta do ta rrëzonte. Kur në rrugët e Beogradit kishte masë të mjaftueshme njerëzish për ta treguar paralizën e pushtetit kundër protestuesve u përdor “topi zanor”, një armë sonike ruse që godet shqisat e protestuesve me ultratingull. I vendosur që të bashkëjetojë me protestën duke llogaritur në lodhjen e lëvizjes dhe sfidat për ruajtjen e kohezionit, pushteti po e lëviz zbrëthimin e konfliktit në pikën që i konvenon, zgjedhjet parlamentare brenda kushteve të tanishme sistemore e funksionale. E brenda atij sistemi- ku për zgjedhje keqpërdoret paraja publike, mediet janë nën kontroll e diferenca mes dhunës së policit dhe kriminelit në shërbim të pushtetit është pothuajse e padukshme - pushteti ka gjasa të vazhdojë tutje.

Sipas anketës së fundit të Faktor Plus, po të mbaheshin zgjedhjet javën e kaluar partia e Vuçiqit SNS, do të kishte fituar 47.1 për qind të votave dhe së bashku me socialistët do të kishin mbi 50 për qind. Forca e dytë më e fortë politike në zgjedhje do të ishte Lista Studentore me 30.7 për qind të votave.

2.

Do kujdes me analogjitë.

Pushtetet në Serbi e Shqipëri mund të duken e të jenë autokraci të prodhuara me zgjedhje (jo aq) demokratike, por kanë dallime thelbësore. Pushteti i sotëm në Serbi është i ndërtuar mbi valën ende të pakonsumuar të urrejtjes së prodhuar të luftërave të zhbërjes së ish Jugosllavisë dhe rolit qendror që kishte Serbia e nacionalizmi serb në të. Pushteti i sotëm në Shqipëri nuk ka fare ngjashmëri; kryeministri Rama ishte një kozmopolit gjatë zhbërjes së ish-Jugosllavisë dhe ekskursionet e tij nacionaliste karshi Kosovës apo Maqedonisë së Veriut viteve të fundit të pushtetit mund të jenë më shumë produkt nevojë protagonizmi regional sesa zgjim i vonshëm i bindjeve. Autokracia në Shqipëri është produkt i rrallë global që ngjizet me bashkëveprimin e pushtetit, grupeve të organizuara kriminale narko-trafiku ndërkombëtar, “oligarkëve” dhe medieve.

Rrjedhimisht, në kulturën politike të Serbisë është e pritshme të nxirren “topat zanorë” e kriminelë me shkopinj bejsbolli për të rrahur pleq, gra e fëmijë që dalin për protestë. Në kulturën politike të Shqipërisë, dhe për këtë ka kontribut edhe kryeministri Rama, nuk është e pritshme që të rrihen njerëzit me kukulla flamingo në dorë apo me pankarta kundër pushtetit, qoftë edhe me mesazhe të skajshme si “vdekje tradhtarëve”.

Për më tepër, analogjia nuk është e vlefshme as në kapacitetin zhvillimor të protestave. Serbia do të mbushë dy vjet proteste, Shqipëria mbushi një muaj. Në kulmin e vet të protestës, nëse nuk ndryshon gjë deri në fund të këtij viti, Serbia do të ketë arritur që të shkojë në zgjedhje parlamentare, në kushte të njëjta e të padrejta si atë më parë, por me një legjitimitet më të madh për një lëvizje të re opozitare, të kryesuar nga studentët. Shqipëria është vetëm në fillim të lëvizjes së saj protestuese dhe për dallim prej asaj serbe, në muajin e parë tashmë ka bërë të qartë se fundi i saj nuk do të jetë pjesëmarrja në zgjedhje në kushte të njëjta si ato të kaluarat.

3.

Pra, jo, Vuçiqi nuk ra dhe në analogji nuk ka arsye të bjerë as kryeministri Rama.

Kryeministri i Shqipërisë i ka në dispozicion po të dyja rrugët e konfrontimit me protestën, e cila për dallim prej asaj të Serbisë, ende është në fazën fillestare dhe me sfida përpara. Asgjëmangut, ka rrugën e bashkëjetesës me protestën me shpresë se ajo disi do të venitet apo shndërrohet në ritual atraksioni turistik. Dhe ka rrugën e konfrontimit në zgjedhje parlamentare, në rast se lëvizja rrit potencialin e vet politik. Në që të dyja rrugët përpara, protestuesit dhe kryeministri vënë bast se do të ketë erozion të kundërshtari; se protestuesit nuk do të arrijnë ndonjë kohezion përfaqësimi apo se kryeministri do të qëndrojë gjithnjë e më i vetmuar në majën e pushtetit të përqendruar kryesisht në duart e tij.

Që të dyja rrugët, përkundër dallimeve thelbësore mes Shqipërisë dhe Serbisë çojnë drejt një përfundimi të synuar nga kryeministrat e tyre, vulosje me demokraci formale zgjedhore, ushtrimin jodemokratik të pushtetit.

4.

Megjithatë, ardhmëria e Shqipërisë do të ketë rrugëtim tjetër prej Serbisë.

Për dallim prej Serbisë, Shqipëria është në formë autentike e orientuar drejt BE-së; popullata e saj, partitë politike, Qeveria, shoqëria civile. Për më tepër, si provë të përkushtimit të saj, ka SPAK-un, një institucion i vendosjes së shembullit të sundimit të ligjit.

Kjo duhej të mjaftonte që Shqipëria të mos e vazhdojë rrugën e Serbisë? Jo.

Përcaktimi i pushtetit pro reformave evropiane tregonte se vendi është i gatshëm të bëjë të gjitha ndryshimet ligjore që kërkojnë nga BE-ja, e kryeministri madje sugjeroi që me këtë punë të mos merren aktorët politikë apo administrata, por që të bëhet me ndihmën e Inteligjencës artificiale, pra që pak a shumë Kuvendi të miratonte formalisht përkthimet e ligjeve evropiane që do t'i bënte ChatGPT.

Mu këtu ilustron diskrepanca, ku reformat evropiane bëhen formë e jo përmbajtje. Shqipëria e pushtetit të sotëm dëshiron në formë autentike të miratojë ligje në përputhje me kërkesat e BE-së dhe në formë autentike të mbajë modelin e tanishëm të zhvillimit të vendit në të cilin mungon transparenca demokratike, ndërsa përligjet me qytetari shembullore paraja e ardhur nga narkotrafiku dhe influenza politike e shoqërore që vjen me të.

Mbajtja e dy besimeve që janë në kundërshtim me njëra-tjetrën quhet disonancë kognitive dhe ky është problem i pushtetit. Por ky është edhe problem i BE-së, sepse është e vërtetë që Shqipëria është plotësisht e drejtuar nga BE-ja, porse ajo në gjendjen e tanishme është po ashtu e drejtuar që modeli i zhvillimit të saj ekonomik të mbështetet në infuzione të mëdha paraje nga burime jolegale. Kjo nuk paraqet një përjashtim nga rregulli i sundimit të ligjit me të cilin duhet të merret SPAK-u, ky është tashmë rregulli.

SPAK-u nuk mund ta zëvendësojë opozitën e as të jetë shpata e idealizuar revolucionare që do të presë koka e të sjellë drejtësi. Revolucioni Flamingo nuk mund ta zëvendësojë Kuvendin e Shqipërisë. BE-ja nuk mund të zëvendësojë Qeverinë e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë nuk mund të zëvendësojë popullin dhe sovranitetin e tij.

Mençuria është tash se si të shfrytëzohet vullneti evropian i Qeverisë, vullneti i BE-së ndaj Shqipërisë, vullneti i SPAK-ut për të luftuar korrupsionin e krimin e organizuar dhe vullneti i protestuesve të Lëvizjes flamingo për ta kthyer vendimarrjen te qytetari - si të shfrytëzohet e tërë kjo energji drejt një qëllimi të përbashkët, që rruga e Shqipërisë të jetë krejtësisht e ndryshme prej asaj ku gjendet këto ditë.

11 Komente



Keln

1 Korrik 2026, 13:05

Ik ore sperme serbi.I paguar nga Serbia anti shqiptar qe po lufton kundra Rep.Kosoves.

[Përgjigjuni](#)

6 3 1



intelegjenca

1 Korrik 2026, 13:30

A ii per sebine e njeh mire se flen e zgjohesh me sebin ne gj.

[Përgjigjuni](#)

2 1 1



Niku

1 Korrik 2026, 13:47

Shkruhet: "Qeveria e Shqipërisë nuk mund të zëvendësojë popullin dhe sovranitetin e tij." Qeveria është produkt i votimit të popullit çdo 4 vjet, pra Qeveria zgjidhet nga populli dhe ka mandat të popullit pa e zëvendësuar atë! Në se quan popull disa qindra mijëra dhe jo të gjithë e ke gabim, sepse quhet "grusht Shteti".

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 1 ❤️ 2

E Eh, ç'na gjeti! Opo lere..

1 Korrik 2026, 14:11

E kush ja kerkoi Veton Shurroit kete analizë. Në, jo një herë. Uh, po. Albini dhe Vetevendosja. Po ta shikoni, mesazhi kryesor i Veton Shurroit është që "protesta në Tiranë është ne fazen fillestare". Vërtet? Wow. Protesta, filloi, arriti kulmin, dhe tani, jo mbaroi, por degradoi. U fut Saliu ne loje me Grupin e Zjarrit. Por, në ndryshim nga protestat e Saliut në Shkurt/ Mars, tani ne loje nuk është vetem Saliu. U be deti kos dhe janë turrur të gjithë me lugë në brezit. Jane të pakten 10 grupe të ndryshme, me bindje te ndryshme, me prirje të ndryshme, me ngritje të ndryshme intelektuale. Keto grupe janë secili per vete. Saliun nuk e rren mendja, por genjen debilët e tij. Ndersa Albini perdor debilët e tij per destabilizim që të rrezohet Rama. Sipas Albinit, kush do që të vijë pas Ramës nuk është aq i zoti sa Albini, dhe ai pastaj vjen triumfator në Tiranë. Pra, Albinin e rren mendja, jo Saliun. Pastaj ke lloj lloj sorollopësh që të gjithë duam nga një cope. Tani doli edhe Veton Shurroi we të bëhet filozofi i protestës, sepse Tos Lubonjën nuk e pordhi njeri. Është turrur edhe Vetoni me lugë në brez, se mos mbaroje kosi.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 1 ❤️ 3

O Oy oycomf799v8

1 Korrik 2026, 14:14

Nuk kane asnje ndryshim,te dy punojne per Serbine kunder Kosoves.Faktet? Ballkani i Hapur,Mitrocica toke e askujt,propozimi per draftin e bashkesise se komunave me shumice serbe,sanksionet e para kunder Kosoves,hedhja ne gjyq e KM te Kosoves R.Hajredinaj,nxitja e percarjes shqiperi-Kosove etj etj qe nuk jane bere publike.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 4 ❤️ 1

O Open AI

1 Korrik 2026, 15:16

Vetoni dhe kosovarët nuk e duan Shqipërinë në Evropë sepse trau në Morinë do jetë kufiri i Evropës dhe kosovarët do e bëjnë pllazhin në lumë ,gjithashtu ushtarët e Albinit nuk do shkelin dot në Tiranë lol

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 3 🗳️ 1 ❤️ 1

S Sem

1 Korrik 2026, 15:47

Ky eshte nje qelbesire me gjith gazetën bota sot,antishqiptar,lëpirës i Albin kurves,surrat mut

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 1 ❤️ 1

S Sokol Palla

1 Korrik 2026, 15:55

E pra e tha troç Vetoni,s'ke ku gjene pershkrim me bukur dhe real : "Autokracia në Shqipëri është produkt i rrallë global që ngjizet me bashkëveprimin e pushtetit, grupeve të organizuara kriminale narko-trafiku ndërkombëtar, "oligarkëve" dhe medieve"

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 1

S Shqiptari

1 Korrik 2026, 16:27

Ik ore fytyr e qelbur, shiko ç po ju bëjnë në Maqedoni at bëj ti se këtu rregullohemi vet ne. Ne kemi të drejtë të flasim shqip, atje tek ju jo. Këtu institucionet flasin dhe shkruajnë shqip tek ju jo; Këtu i zgjidhim vet hallet tona atje tek ju jo; Këtu emrat e rrugëve, të shkollave, etj etj janë shqip

kurse tek ju jo; Këtu mund të themi çfarë të duam kurse atje tek ju jo, qeveria këtu nuk të fut në burg si atje. Ik ore Veton se dole inatçi e nuk po them më shumë dole një antishqiptare.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 1 ❤️ 1



Luani

1 Korrik 2026, 18:03

Ore tani po i jape te drejte enverit, shumica e tyre jane perpunuar mga udb, , e provuan edhe me thacin, 80- shqiptar kosovar deshmitar kunder, eshte te veshe kujen...!!

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 1



Lala plak

1 Korrik 2026, 18:21

Ik mor klysh i bushtres serbe dhe qeneve te xhafer deve , rexhep mirovices e me te ndyrit nder barbaret sali berishes. O vemje serbe

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.